



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 213/5 prot.

Tiranë, më 9.6.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 249, datë 6.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Piro Samara
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, të Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, në datën 28.5.2020, është njoftuar vendimi nr. 249, datë 6.3.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Piro Samara, i cili ka ushtruar funksionin e Inspektorit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 249, datë 6.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Piro Samara, sipas ligjit të kohës në fuqi, në shtator të vitit 2009 është emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) në pozicionin e Inspektorit me mandat pesëvjeçar. Në maj të vitit 2016, me vendimin e ish-KLD-së, z. Samara është rizgjedhur edhe për një mandat të dytë pesëvjeçar, i cili do të përfundonte në datën 27.5.2021¹.

2. Në aktet shoqëruese të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit gjenden këto dokumente:

- (i) Kërkesa e nënshkruar nga subjekti z. Samara, drejtuar ndër institucioneve të tjera, edhe Komisionit, protokolluar nga ky i fundit me nr. *** prot., datë ***.5.2018, me lëndë: “Përrjashtim nga testimi i njoftuar nga Shkolla e Magjistraturës, për efekt të procesit të rivlerësimit profesional, parashikuar nga ligji nr. 84/2016”;
- (ii) Vendimi nr. 223, datë 22.10.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për vlerësimin individual dhe karrierën për z. Piro Samara”, në të cilin është vendosur deklarimi i mospasjes së statusit “Magjistrat” për këtë subjekt, dhe
- (iii) Urdhri “Për Lirimin nga Detyra”, me nr. ***, datë ***.10.2019, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku ndër të tjera referohet kërkesa e subjektit z. Samara për dorëheqje nga detyra, protokolluar me nr. *** prot., datë ***.7.2019, urdhërohet lirimi nga detyra si Inspektor i ish-KLD-së, për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit **dhe kërkesës së tij për dorëheqje**, si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës prej datës 4.11.2019.

3. Komisioni, më datë 16.1.2020, ka shortuar çështjen dhe ka caktuar kryesuesin për shqyrtimin e rastit të subjektit të rivlerësimit z. Samara. Më pas, më datë 6.3.2020, mbi bazë dokumentesh, trupi gjykues mbështetur në nenet 14 dhe 57, të ligjit nr. 84/2016, nenin 95², të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, germa “c³”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me vendimin nr. 249, datë 6.3.2020, ka vendosur:

- (i) Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për z. Piro Samara, me funksion Inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk duhet të nisë ose duhet të konsiderohet i pushuar;
- (ii) Ky vendim u njoftohet z. Piro Samara, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë;

¹ Referuar të dhënave të reklamuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e tij me lëndë: “Përrjashtim nga testimi i njoftuar nga Shkolla e Magjistraturës, për efekt të procesit të rivlerësimit profesional, parashikuar nga ligji nr. 84/2016”, drejtuar ndër të tjera Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar pranë këtij institucioni me nr. *** prot., datë ***.5.2018.

² Pamundësia në objekt apo qëllim - “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

³ KREU VIII-Mbarimi i statusit të magjistratit - Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit – “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: c) mbush moshën 67 vjeç”.

(iii) Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga z. Piro Samara dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Në arsyetimin e vendimit, Komisioni vlerëson se neni 179/b, pika 3, e Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen *ex officio* të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, prokurorët, këshilltarët, kryeinspektori **dhe inspektorët e KLD-së**.

5. Neni 64, germa “c”, e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, parashikon se një nga arsytet për mbarimin e statusit të gjyqtarit është mbushja e moshës për pension. Dispozitat kalimtare, neni 160, germa “ë”, e këtij ligji parashikon se një nga kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vërtetimi i ndërprerjes së emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit, ku për analogji si shkak konsiderohet edhe mospasja apo humbja e statusit të magjistratit.

6. Për sa më lart, Komisioni ka konstatuar se nga momenti që z. Piro Samara nuk ka statusin e magjistratit, nuk mund të jetë një nga subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se objekti dhe qëllimi për të cilin synon procedura e rivlerësimit është bërë i pamundur.

III. Shkaqet e ankimit

7. Komisioneri Publik, pas vlerësimit të rrethanave dhe fakteve të administruara nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit z. Samara, në konsideratë të përcaktimit në nenin 179/b të Kushtetutës dhe vendimmarrjes së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për raste të ngjashme⁴, çmon se vendimi nr. 249/2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave kushtetuese dhe ligjit të aplikueshëm. Në rastin konkret, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Piro Samara nuk duhet të përfundonte, pushonte në mungesë të vlerësimit të vullnetin të tij të shprehur për vijimin apo dorëheqjen nga procesi, dhe eventualisht nëse jemi në kushtet e zbatimit të nenit G, të aneksit të Kushtetutës.

8. Nisur nga arsyetimi i vendimit objekt ankimi, pjesën përshkruese arsyetuese dhe asaj urdhëruese, në raport me aktet e administruara dhe ligjin e aplikueshëm, mbetet e paqartë shkaku përcaktues i pushimit të procedurës nga ana e Komisionit. Në vendim nuk referohen fakte apo prova mbi të cilat Komisioni ka vlerësuar sipas nenit 64, germa “c” dhe dispozitës kalimtare, nenit 160, pika 1, germa “ë”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, si dhe vendimin e organit kompetent që ka vlerësuar këtë situatë ligjore, e për rrjedhojë, ndikimi në ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit.

9. Komisioneri Publik konstaton se për aktet shoqëruese të vendimit të Komisionit, të ardhura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), nga përmbajtja e vendimit nuk rezulton si këto

⁴ Vendimi (JR) nr. 1/2018, nr. 5/2018 dhe atë me nr. 17/2019.

akte janë administruar apo vlerësuar, si dhe nëse ndaj tyre, vendimit dhe urdhrin të KLGJ-së, është ushtruar ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit, praktikë kjo e ndjekur në raste të ngjashme nga Komisioni⁵.

10. Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në nenin 179/b, pika 3, të Kushtetutës, z. Piro Samara ka marrë cilësinë e subjektit që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar prej momentit të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në vijim të këtyre ndryshimeve kushtetuese doli dhe ligji që përcaktonte afatet dhe procedurat për qëllim të procesit të rivlerësimit, ligji nr. 84/2016, i cili hyri në fuqi më datë 8.10.2016. Si pasojë e pezullimit nga Gjykata Kushtetuese, afatet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit u pezulluan nga data 25.10.2016 deri më datë 19.1.2017, datë kjo e cila e gjeti subjektin në të njëjtën detyrë funksionale.

11. Kjo situatë ligjore merr rëndësi, pasi dikton në të drejtat dhe detyrimet e subjektit, duke e konsideruar subjekt të procesit të rivlerësimit kalimtar për shkak detyrë (*ex officio*). Ky status mund të ndryshojë duke u *pushuar apo ndërprerë*, si shkak i vullnetit të subjektit me anë të dorëheqjes, në dy raste, ai i parashikuar në nenin 56, të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin G, të aneksit të Kushtetutës, ku qëllimi i të dyja dispozitave ka qenë mundësia që subjektet të largohen me dëshirë, pa iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit.

12. Në vështrim të sa më sipër, z. Samara duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si shkak i funksionit që ushtronte, atë të Inspektorit të ish-KLD-së dhe në rast dorëheqjeje të tij të gjente zbatim neni G, i aneksit të Kushtetutës. Konstatojmë se Komisioni i referohet dispozitave ligjore për arritjen e moshës së daljes në pension, por ky fakt nuk rezulton i provuar. Sipas kërkesës të z. Samara, me nr. *** prot., datë ***.5.2018, drejtuar ndër të tjera edhe Komisionit, subjekti deklaroi se është i datëlindjes 1969, pra 51 vjeç.

13. Në këto kushte, rezulton se Komisioni nuk ka identifikuar dhe vlerësuar drejt faktet dhe rrethanat ligjore mbi të cilat ka ndërprerë/pushuar procesin e rivlerësimit dhe nëse ndodhemi në kushtet e dorëheqjes, sikurse referohet në Urdhrin nr. ***, datë ***.10.2019, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky fakt do të mundësonte për Komisionin që, në zbatim të orientimit të dhënë në vendimet (JR) nr. 1/2018 dhe nr. 5/2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të verifikonte:

- i* vullnetin e lirë dhe të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje⁶;
- ii* rrethanat konkrete, nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin⁷;
- iii* caktimin e ndalimit të emërimit për periudhën 15-vjeçare, sipas pikës 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës, në dispozitivin e vendimit.

⁵ Si shembull, referohuni në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 251, datë 9.3.2020.

⁶ Prg. 55 i vendimit nr. 1/2018: [... paraqitja sipas ligjit e aktit të dorëheqjes, i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit, duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme dhe, si e tillë, bën pjesë te rastet përjashtimore, në kushtet kur edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është dhënë në dorëheqjen e paraqitur...].

⁷ Prg. 54 i vendimit nr. 1/2018: [E drejta për t’u dëgjuar publikisht përfshin në vetvete të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, përveçse kur ka rrethana përjashtimore. Si raste përjashtimore, Kolegji i Apelit vlerëson edhe rastet e dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit nga procesi i rivlerësimit kalimtar, duke respektuar parimin e transparencës në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt, të sanksionuar nga neni Ç, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Duke iu referuar nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili referon Kodin e Procedurave administrative, neni 89, i cili përcakton rastet e mbylljes së procedurës administrative, pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar.]

14. Duke vepruar kryesisht si më sipër, eventualisht arrihej në përfundimin se për rastin konkret duhet të gjejë aplikim neni G, i aneksit të Kushtetutës, pasi sikurse dhe Kolegji ka mbajtur qëndrim në vendimin (JR) nr. 17/2019: *[... vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit.]*

IV. Kërkimi i ankimit

15. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

16. Duke gjetur me vend të nënvizojë se në zbatim të orientimit të dhënë nga ana e Kolegjit në vendimet (JR) nr. 1/2018 dhe nr. 5/2018, si dhe qëndrimit në vendimin (JR) nr. 17/2019, ruajtja e një standardi interpretimi dhe zbatimi të legjislacionit në raste të ngjashme është e nevojshme të garantohet;

17. Bazuar në nenin F dhe G, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së lartpërmendur të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese;

18. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 249, datë 6.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA